



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2024:088151

Datë: 14.05.2024

Numri i dokumentit: 05679285

P.nr.104/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, Gjyqtarja e vetme gjykuese Qëndresa Tahiri Islami, me bashkëpunëtoren profesionale Edita Koliqi, në çështjen penale ndaj të pandehurit: O.A, për shkak të veprave penale: I.Kanosja nga neni 181 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1 të Kodit (nr. 06/L-074) Penal Të Republikës së Kosovës (tutje si: *KPRK*), II. Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 3, nën paragrafi 3.1 e lidhur me nenin 1, pika 1.4 të *KPRK*-së, III. Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të *KPRK*-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.453/2024 të datës 05.04.2024, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar me datë 16.04.2024, në mungesë të prokurorit të shtetit Arjan Xhema, e në praninë e të pandehurit O.A, mbrojtëses së tij sipas detyrës zyrtare, avokate Shqipe Mehmeti – Jusufi, si dhe të dëmtuarës F.A, me datë 17.04.2024 shpalli publikisht, ndërsa me datë 14.05.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

O.A, nga i ati M..., e ëma Xh..., e vajzërisë F..., i lindur me datë në fshatin B..., Komuna e M..., ku edhe jeton, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, baba i gjashtë fëmijëve, punëtor i, me numër personal të identifikimit, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

I

SEPSE:

Më datë 18.03.2024, rreth orës 15:00, në M...., në fshatin B...., konkretisht në shtëpinë e tyre të përbashkët, i pandehuri me dashje dhe me fjalë serioze e kanos të dëmtuarën- bashkëshorten e tij, në atë mënyrë që, pas një mos marrëveshje në mes tyre, i pandehuri i thotë “ko met vra”, e më pas i thotë vajzës së tij A... “ hyp në tavan dhe bima armën” , me çka tek e dëmtuara është shkaktuar ndjenja e frikës, ankthit dhe pasigurisë,

-Me këtë ka kryer veprën penale Kanosja nga neni 181 par. 4 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

II

Me datë, kohë dhe vend si në pikën e parë të dispozitivit të aktvendimit, i pandehuri me dashje i shkakton lëndime trupore personit tjetër dhe atë dëmtuarës - bashkëshortes së tij F.A, në atë mënyrë që, pas një mos marrëveshje në mes tyre, mosmarrëveshje e cila kishte ardhur si pasojë e xhelozisë së të pandehurit, i njëjti e kishte lënduar në duar, lëndime të cilat janë konstatuar nga ekspertiza mjeko ligjore si ndrydhje (mrejtje) te indeve te buta dhe me gjakmbledhje nenlëkurore ne te dy faqet e fytyrës, ne regjionin e parakrahut te dorës se majte dhe ne regjionin e shuplakës se dorës se djathte, me besueshmëri te shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit te forte mbretes (jo i mbreht, i topitur), andaj si te tilla, një nga një dhe se bashku, kualifikohen ne Lëndime te Lehta Trupore – te shoqëruara me dëmtime te përkohshme te shëndetin,

-Me këtë ka kryer veprën penale Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par. 3 nen par 3.1 e lidhur me nenin 1 pika 1.4 të Kodit nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës.

III

Deri më datë 18.03.2024, i pandehuri me dashje dhe në kundërshtim me ligjin për armën, Ligjin nr. 05/L-022, ka mbajtur në posedim armën e gjatë AK- 47, pa numër serik, një karikator dhe 13 fishke të po të njëjtës armë, armë e cila kishte qenë në dhomë të gjumit në momentin e shkuarjes së Policisë së Kosovës në shtëpi dhe e njëjta është sekuestruar nga Policia e Kosovës,

-Me këtë ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së.

Andaj, Gjykata, në bazë të nenit 1, 4, 7, 17, 21, 38, 40, 43, 46, 47, 48, 49, 69, 71, 72, 76, 78, si dhe neni 181, 185, 366 të KPRK-së, dhe neni 358, 364, 449, 462, 276 të KPP-së, i :

S H Q I P T O N

Për veprën penale si në pikën I;

- DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej 11 (njëmbëdhjetë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale gjatë periudhës së verifikimit, në kohëzgjatje prej dy (2) viteve, nga plotfuqishmëria e këtij Aktgjykimi.

Për veprën penale si në pikën II;

- DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej 5 (pesë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale gjatë periudhës së verifikimit, në kohëzgjatje prej dy (2) viteve, nga plotfuqishmëria e këtij Aktgjykimi.

Për veprën penale si në pikën III;

- DËNIM ME GJOBË në shumë prej 600 (gjashtëqind) euro, të cilën dënim-gjobë obligohet ta paguaj 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Gjykata, në mbështetje të nenit 76 të KPRK-së, të pandehurit O.A, i:

S H I P T O N

-DËNIM UNIK me burgim të kushtëzuar në kohëzgjatje prej 1 (një) viti e 3 (tre) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale gjatë periudhës së verifikimit, në kohëzgjatje prej dy (2) viteve, nga plotfuqishmëria e këtij Aktgjykimi.

-DËNIM UNIK me gjobë në shumë prej 600 (gjashtëqind) euro, të cilin dënim-gjobë obligohet ta paguaj brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga plotfuqishmëria e këtij Aktgjykimi. Nëse i pandehuri nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar, gjykata do të veprojë në bazë të nenit 43 par.3 të KPRK-së, ashtu që të pandehurit, dënimin me gjobë do të i'a zëvendësoj në dënim me burgim duke llogaritur për çdo 20 (njëzetë) euro gjobë të papaguar, me një (1) ditë burgim.

Në mbështetje të nenit 276 par.1 dhe 2, nën-par.2.1 të KPP-së dhe nenit 366 par.3 të KPRK-së, KONFISKOHET sendet, dhe atë:

- a. Një pushkë automatike AK-47, pa numër serik.
- b. 13 (trembëdhjetë) fishek të armës së njëjtë.
- c. Një karikator.

-Pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi, kjo armë duhet të shkatërrohet nga Policia e Kosovës, në bashkëpunimin me Prokurorinë Themelore në Mitrovicë, pasi që të vërtetohet se kjo armë nuk është përdorur në ndonjë krim tjetër.

-Të pandehurit O.A, koha e kaluar në masën e paraburgimit nga data 18.03.2024 e deri me datë 16.04.2024 i llogaritet në dënimin e shqiptuar unik me burgim të kushtëzuar.

-Obligohen i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguajë shumën prej njëzet (20) euro dhe në emër të Fondit për Kompensimin e viktimave të krimit shumën prej njëzet (20) euro, ndërsa në emër të ekspertizës mjeko ligjore shumën prej njëzet (20) euro. Të gjitha këto i akuzuarit është i obliguar që t'i paguajnë brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

-Pala e dëmtuar F.A, për kërkesën pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt juridiko – civil.

A R S Y E T I M

Aktakuza

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP.II.453/2024 të datës 05.04.2024, ndaj të pandehurit: O.A, për shkak të veprave penale: I.Kanosja nga neni 181 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, II. Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 3, nën paragrafi 3.1 e lidhur me nenin 1, pika 1.4 të KPRK-së dhe III. Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK-së.

Rrjedha e procedurës

Gjykata, me datë 16.04.2024, ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, në praninë e prokurorit të shtetit Arjan Xhema, të dëmtuarës F.A, si dhe të pandehurit O.A me mbrojtësen e tij sipas detyrës zyrtare, avokate Shqipe Mehmeti - Jusufi.

I pandehuri, gjatë seancës së shqyrtimit fillestar, pas njoftimit nga gjykata me të drejtat e tij në këtë fazë të procedurës penale dhe leximit të aktakuzës, ka pranuar fajësinë në tërësi për veprat penale sipas aktit akuzues. I njëjti ka shprehur keqardhje dhe pendim për atë se çfarë ka ndodhur, ka theksuar se ka qenë hera e parë që ka ndodhur dhe se më asnjëherë nuk do të përsëriten vepra të tilla, e po ashtu shprehi kërkim falje ndaj të dëmtuarës dhe gjithë të pranishmëve.

Gjykata ka marrë mendimin e palëve në lidhje me deklarinimin mbi pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.

Prokurori i rastit Arjan Xhema, ka dhënë mendimin e tij lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri, ashtu që i propozoi gjykatës ta miratoj pranimin e fajësisë, pasi që është bërë në mënyrë vullnetare, konform dispozitave ligjore të nenit 242 të KPP-së, pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësen e tij dhe në përputhje me provat që gjenden në shkresat e lëndës. Gjykatës i propozoi që i njëjtin të shpallet fajtor, të i shqiptohet një sanksion penal me të cilin do të arrihet qëllimi i dënimit, si rrethanë lehtësuese të merret parasysh pranimi i fajësisë, ndërsa si rrethanë rënduese shkalla e përgjegjësisë penale, intensiteti i rrezikimit apo vlerës së mbrojtur.

E dëmtuara F.A, gjatë dhënies së mendimit të saj për pranimin e fajësisë nga i pandehuri, gjykatës i propozoi që të pranohet pranimi i fajësisë, ndër të tjera ka shtuar se asnjëherë më parë nuk ka qenë e kanosur e as nuk kanë pasur problem dhe se më nuk do të kenë problem të tilla, çdo gjë ka qenë e qastit dhe ka ndodhur për shkaqe të xhelozise sime.

Mbrojtësja e të pandehurit, av.Shqipe Mehmeti – Jusufi, fillimisht ka mbështetur pranimin e fajësisë nga i pandehuri, duke konsideruar se ky pranim ka mbështetje në provat material që gjenden në shkresat e lëndës, është bërë në mënyrë vullnetare dhe pas konsultimit të mjaftueshme me të si mbrojtëse. Lidhur me rrethanat e matjes së dënimit, gjykatës i propozoi që si rrethanë lehtësuese të merret pranimi i fajësisë, pendimi i shprehur, kërkim falja ndaj të dëmtuarës, premtimi i dhënë që më nuk do të përsëriten veprat e tilla, pastaj faktin se ka qenë hera e parë që ka ra ndesh me ligjin dhe se asnjëherë nuk ka pasur probleme me bashkëshortën

e tij, si dhe faktin se i pandehuri është kryerfamiljar dhe se e gjithë ekzistenca e familjes varet nga ai.

Gjetjet e Gjykatës

Gjykata ka shqyrtuar pranimin e fajësisë të deklaruar nga i pandehuri O.A, në mbështetje të nenit 242 të KPP-së, ka vlerësuar se janë përmbushur kushtet ligjore për miratimin e pranimit të fajësisë për të pandehurin. Gjykata gjen se pranimi i fajësisë nga i pandehuri mbështetet në tërësi në provat që përmban kjo akuzë, siç janë: Akt ekspertimi mjeko-ligjor i datës 22.03.2024; Marrja në pyetje e të pandehurit O.A në P.Th. Mitorivicë e datës 05.04.2024; Raporti fillestar i incidentit me numër të rastit 2024-BC-239 i datës 18.03.2024; Procesverbali i marrjes në pyetje për të dëmtuarën F.A i datës 18.03.2024; Foto albumi nga shkresat e lëndës; Procesverbali i marrjes në pyetje së dëshmitares A.A i datës 06.04.2024; Procesverbali mbi marrjen në pyetje për të pandehurin O.A i datës 18.03.2024; Vërtetimi mbi sekuestrimin e sendeve i datës 18.03.2024 dhe foto albumi mbi sendet e sekuestruara. Të gjitha këto prova janë bindëse dhe formojnë në tërësi elementet inkriminuese, e që në bazë të tyre dhe pranimit të fajësisë nga i pandehuri, përtej çdo dyshimi vërtetohet se i pandehuri ka kryer veprat penale sipas aktit akuzues.

Gjykata gjen se pranimi i fajësisë nga i pandehuri është bërë në mënyrë vullnetare, pasi që ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë. Gjykata i'a kishte tërheq vërejtjen të pandehurit se pas pranimit të fajësisë nuk mundet ta shfrytëzojë të drejtën në ankesë, lidhur me bazën për gjendjen faktike, i njëjti është njoftuar se nëse e pranon fajësinë humb mundësinë e kundërshtimit të provave në aktakuzë dhe mundësinë për paraqitjen e provave tjera, si dhe për faktin se pranimi i fajësisë sipas ligjit është një rrethanë lehtësuese që me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata mund të shqiptoj një dënim më të butë. Gjykata gjithashtu ka vërtetuar se aktakuza në këtë rast nuk përmban asnjë shkelje ligjore e as ndonjë gabim faktik dhe nuk ka bazë për hedhjen e akuzës.

Gjykata bazuar në pranimin e fajësisë nga i pandehuri dhe mbi bazën e provave të cekura si më lartë, përtej çdo dyshimi ka vërtetuar se i pandehuri O.A është i përgjegjshëm dhe përgjegjës për veprat penale për të cilat akuzohet.

Matja e llojit dhe lartësisë së dënimit:

Gjykata, lidhur me caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin O.A, ka vlerësuar rrethanat për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 69 të KPRK-ës, e si rrethanë rënduese ka

vlerësuar, dashjën direkte të pandehurit lidhur me veprat penale, përgjegjësinë dhe përgjegjshmërinë e plotë, kontributin esencial të tij në këto vepra penale, faktin se natyra e këtyre veprave penale janë të shpeshtuara në Kosovë, se kemi të bëjmë me vepër penale të kryer ndaj anëtarëve të ngushtë të familjes respektivisht bashkëshortes së tij, si dhe rrezikshmërinë që paraqesin këto vepra penale.

Ndërsa si rrethanë lehtësuese ka marrë për bazë faktin se i njëjti ka treguar sjellje të mira dhe paraqitje serioze në gjykatë në raport me gjykatën dhe palët, faktin se i pandehuri ka shprehur keqardhje dhe pendimin e te thellë publikisht për veprimet e kryera penale dhe premtimin se më nuk do të përsërisë veprime të tilla, kërkim faljen të dëmtuarës, pastaj rrethanat personale, pasi që i njëjti është baba i gjashtë fëmijëve, është në marrëdhënie punë dhe nga të ardhurat që realizon, mban dhe kujdeset për familjen e tij. Ndërsa si rrethanë posaçërisht lehtësuese për të pandehurin është vlerësuar pranimi i fajësisë në tërësi për veprat penale që akuzohet, gjë që kjo është rrethanë që gjykata, me rastin e shqiptimit të dënimit ka marrë për bazë për zbutjen e dënimit nën kufirin e paraparë ligjor në raport me veprën penal të Kanosjes, kjo duke u mbështetur në dispozitat e nenit 71 par.1, nën-par.1.3 dhe nenit 72 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të KPRK-së.

Duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana si dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, gjykata vlerëson se, shqiptimi i dënimit unik me burgim të kushtëzuar dhe dënimi me gjobë ndaj të pandehurit është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprave penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Po ashtu, gjykata vlerëson se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 par.1 të KPRK-së, që t'i parandaloj kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, si dhe të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Sa i përket dënimeve me gjobë në këtë rast për të pandehurit gjykata përveç rrethanave të cekura, ka vlerësuar dhe ka marrë parasysh edhe kushtet dhe mundësitë materiale për pagimin e gjobës, duke vlerësuar se dënimi me gjobë i shqiptuar për të pandehurin është i përballeshëm për kushtet ekonomike të tij.

Konfiskimi

Gjykata në mbështetje të nenit 276 par.1 dhe 2, nën-par.2.1 të KPP-së, si dhe neneve 366 , ka bërë konfiskimin e detyrueshëm e të përhershëm të armës: një pushkë automatike AK-47, pa numër serik, 13 (trembëdhjetë) fishek të armës së njëjtë dhe një karikator.

Gjykata rikujton se i pandehuri nuk kishte leje e as autorizim për posedimin e armës. Në anën tjetër sendet e lartcekura bëjnë pjesë në sendet që konfiskohen në mënyrë automatike nga këto arsye gjykata ka vendosur t'i konfiskoj përhërë dhe të njëjtat ka urdhëruar që të shkatërrohen. Gjykata vlerëson se në këtë rast plotësohen kushtet ligjore për konfiskimin e përhershëm të armës sipas nenit 366 par.3 të KPRK-së, që rregullon konfiskimin e detyrueshëm, konfiskimi poashtu ishte propozuar në aktakuzë – dispozita e lartcekur e këtij Kodi, përcakton shprehimisht konfiskimin e detyrueshëm të saj.

Ndërprerja e masës së paraburgimit:

Gjykata, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ashtu që të pandehurit i'a ka ndërprerë masën e paraburgimit, me rastin e shpalljes së aktgjykimit. Në lidhje me këtë Gjykata ka lëshuar vendim të veçantë ku edhe i ka dhënë arsyet për një vendim të tillë. Po ashtu të pandehurit kohën e kaluar në masën e paraburgimit, nga data 18.03.2024 e deri me datë 16.04.2024, i'a ka llogaritur në dënim e shqiptuar me burgim të kushtëzuar. Kjo duke u bazuar në nenin 79 të KPRK-së, ku përcaktohet se koha e kaluar në paraburgim llogaritet në dënimin e shqiptuar.

Vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449 të KPP-së, që kanë të bëjnë me shpenzimet e procedurës dhe ato për paushall gjyqësor. Ndërsa taksa për kompensimin viktimave të krimit, në kuptim të nenit 39 par. 3 të Ligjit nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Sa i përket kërkesës pasurore juridike, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit bazuar në nenin 462 të KPP-së, ashtu që të dëmtuarën e udhëzoi në kontest të rregullt juridiko – civil.

Andaj gjykata duke u bazuar në dispozitat ligjore të nenit 364, 276, 449, 462 të KPPK-ës nga arsyeje e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti i Përgjithshëm

P.nr.104/2024, datë 14.05.2024

Bashkëpunëtore profesionale

Edita Koliqi

Gjyqtarja e vetme gjykuese

Qëndresa Tahiri - Islami

Këshillë juridike: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit Prishtinë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimin të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.